

## ÇFARE ËSHTË ECTS?

ECTS (European Credit Transfer System - Sistemi Europian i Transferimit të Krediteve) u ngrit nga Komisioni i Bashkimit Europian, me qëllim që të bëjë të mundur kryerjen e procedurave të zakonshme, të cilat sigurojnë njohjen akademike të studimeve jashtë shtetit. Ky sistem realizon matjen dhe një mënyre krahasimi të arritjeve në procesin e të mësuarit, si dhe të transferimit të tyre nga njëri universitet në tjetrin.

Sistemi ECTS bazohet në parimin e besimit të ndërsjelltë midis institucioneve të arsimit të lartë, që përfshihen në këtë sistem. Rregullat, që kanë të bëjnë me informimin (mbi lëndët në dispozicion), marrëveshjen (midis institucionit mëmë dhe atij pritës) dhe përdorimin e pikëve të kreditit (që tregojnë ngarkesën e studentit), vendosen për ta bërë të mundur këtë besim të ndërsjelltë. Në këtë sistem, çdo departament, paraqet përshkrimin e kurseve që ai ofron, si dhe kreditet për çdo lëndë.

Kreditet ECTS janë vlera numerike (nga 1 deri në 60), që caktohen për çdo lëndë dhe përshkruajnë ngarkesën që studenti duhet të plotësojë, në mënyre që të konsiderohet kalues. Ato pasqyrojnë sasinë e punës së plotë që kërkohet për çdo lëndë, në raport me sasinë e punës së plotë, të nevojshme për të përfunduar një vit akademik studimi në universitet. Kjo punë përfshin leksionet, punët praktike, seminarët, ushtrimet, konsultimet, studimin individual (në bibliotekë ose shtëpi), provimet ose mënyra të tjera vlerësimi. Kështu, ECTS-ja nuk bazohet vetëm në orët që kanë të bëjnë me pjesëmarrjen në mësim, por në të gjithë ngarkesën e plotë të studentit. Pra, ajo përmban si punën në auditor, ashtu edhe atë jashtë auditorit.

Është pranuar që një vit shkollor të ketë 60 kredite.

Kreditet fitohen vetëm atëhere kur lënda kryhet e tëra dhe kur shlyhen me sukses të gjitha detyrimet e kërkuara për këtë lëndë.

Studentët, që përfshihen në sistemin ECTS, i marrin të gjitha kreditet për punën vjetorë akademike të kryer në çdo universitet partner të ECTS-së dhe mund t'i transferojnë ato nga një universitet pjesëmarrës në një tjetër, në qoftë se paraprakisht egziston marrëveshje midis institucioneve që bëjnë pjesë në këtë sistem.

Studentët, që duan të studjojnë jashtë shtetit, duhet të kontaktojnë me koordinatoren e institucionit të tyre mëmë, të studjojnë Paketat e Informacionit të institucioneve të tjera, për të zgjedhur drejtimin që dëshirojnë dhe për të planifikuar planin mësimor të studimit në universitetin pritës. Ky plan duhet të miratohet paraprakisht nga të dy institucionet, si ai mëmë ashtu edhe ai pritës.

Institucionet mëmë dhe pritës përgatisin dhe shkëmbejnë Dëftesat e Rezultateve, për çdo student që merr pjesë në ECTS, para dhe pas periudhës së studimeve. Një kopje e tyre i jepet studentit për ta pasur në dosjen personale.

Çdo universitet ka shkallen e vet të notave. Për të përkthyer notat nga një universitet në tjetrin, është pranuar një shkallë e përbashket e notave, e quajtur shkalla ECTS e notave.